



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL
KËSHILLI BASHKISE DEVOLL**

VENDIM

Nr. 110 date 24.12.2018

**PER MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE TE BASHKISE DEVOLL
PER VITIN 2019**

Bazuar ligjin “ Për buxhetin e vitit 2019”, Ligji nr.9632 date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore “ i ndryshuar, ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, ligji nr.9723 datë 03.05.2007 “Për qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”, I ndryshuar, ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, V.K.M nr.132 datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesa, bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit të të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës , si dhe kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat “ i ndryshuar, ligji nr.10081 datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar, ligji nr.9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” I ndryshuar, ligji nr.107/2014 date 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ligji nr.10465 datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative” ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve “ i ndryshuar, V.K.M. nr.505 datë 01.08.2007 “Për miratimin e statutit të Qëndres kombëtare të Regjistrimit”, V.K.M Nr.783 datë 10.11.2001 “Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njesitë e qeverisjes vendore” I ndryshuar, V.K.M Nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, V.K.M Nr.391 datë 21.03.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave” I ndryshuar V.K.M nr.285 datë 27.06.2002 “Për tarifat e shërbimeve që kryen Policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridike, fizike, vendas dhe të huaj” Ligjit nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjin nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, Ligji nr.8519 datë 30.07.1999 “ Për Ujitjen dhe Kullimin” , Ligji nr.10465 datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, Keshilli i Bashkise Devoll me 16 vota pro , asnje abstenim dhe asnje kunder:

VENDOSI:

1. Të miratojë sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2019 sipas relacionit të Buxhetit.
2. Të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak që bien në kundërshtim me këtë akt shfuqëzohen.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha strukturat e Bashkisë Devoll.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen Vendore”

**KRYETARI I KËSHILLIT
ALBERT LILO**

